



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 192 prot.

Kamëz, më 21.12.2022

V E N D I M
Nr. 165 .Datë 21/122022
M B I

“APLIKIMIN E REGJISTRIMIT DHE PAJISJES ME ÇERTIFIKATË PRONËSIE TË OBJEKTEVE TË RINDËRTUARA REFERUAR VENDIMIT NR. 904, DATË 24.12.2019”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.146 Datë 19.12.2022 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, Vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, Vendimit nr. 748, datë 9.12.2021 “Për kalimin të Bashkitë Durrës, Shijak Dhe Kamzë të njësive individuale të banimit”, Vendimit nr. 319, datë 18.5.2022 “Për kalimin të Bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë Dhe Krujë të njësive individuale të banimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Drejtorisë së Rindërtimit për mbulimin e shpenzimeve të aplikimit për regjistrimin dhe pajisjen me çertifikatë pronësie të 43 (dyzet e tre) objekteve të rindërtuara, si pasojë e dëmtimeve nga tërmeti i datës 26.11.2019.
2. Kërkesa e mësipërme i referohet Vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, në kontratën e kalimit të pronësisë, neni 2, pika 2.3, citohet që “ Bashkia Kamëz (në rastin konkret) do të kryejë procedurat e kalimit të pronësisë të banesës të përfituesit, sipas parashikimeve të këtij neni, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontratës, si dhe merr përsipër të mbulojë të gjitha detyrimet dhe kostot në lidhje me shpenzimet noteriale dhe regjistrimin e kësaj kontrate pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës brenda 30 ditëve nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

data e nënshkrimit të saj". Duke qenë se VKM-të e sipërcituara, përkatësisht nr. 748, datë 9.12.2021 dhe 319, datë 18.5.2022, për kalimin e njësive individuale, kanë të përcaktuar subjektin në emër të cilit është objekti i rindërtuar, dhe aplikimi do të bëhet në emër të qytetarit nga portali e-albania, duke mbuluar tarifën e plotë të regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie, por duke shmangur shpenzimet noteriale për kalimin e pronësisë.

3. Lista e familjeve për të cilët do të mbulohet tarifa e aplikimit paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

Totali i shpenzimeve është në vlerën 434300 lekë, dhe do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

